



This project is funded
by the European Union



GUIDË

PËR SHËRBIMET E NDIHMËSIT PERSONAL

Përmbajtja

HYRJE	11
SI PËRFITOHET NDIHMËSI PERSONAL NGA PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA?	3
KUSH KONSIDEROHET NDIHMËS PERSONAL?	3
KUSH MUND TË JETË NDIHMËS PERSONAL?	3
CILAT JANË KRITERET QË DUHET TË PLOTËSOJË NDIHMËSI PERSONAL?	4
CILI ËSHTË DOKUMENTACIONI QË DUHET TË DORËZOJË NDIHMËSI PERSONAL DHE KU?	4
ÇFARË BËN NDIHMËSI PERSONAL?	4
SA ËSHTË PAGESA E NDIHMËSIT PERSONAL?	5
KUSH I MONITORON SHËRBIMET E NDIHMËSIT PERSONAL?	5

Kjo Guidë është hartuar nga FShDPAK në kuadrin e projektit “*Shërbime të informimit dhe ndihmë ligjore parësore për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre në Shqipëri*” që po zbatohet si pjesë e programit “*Përgjigje gjithëpërfshirëse ndaj #COVID19 për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre*” të zbatuar nga World Vision, me mbështetjen e Bashkimi Evropian në Shqipëri, në bashkëpunim me 6 organizata që punojnë në fushën e aftësisë së kufizuar, ADRF, MEDPAK, DSA, ANAD, Help the Life dhe Together for Life.

HYRJE

Kjo guidë hartohet në kuadër të projektit "Reagim përfshirës për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre në Shqipëri për COVID-19 - Shërbime të informimit dhe ndihmë ligjore parësore për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre në Shqipëri" dhe ka për qëllim informimin, pikësëpari të komunitetit të personave me aftësi të kufizuara, por edhe publikun e interesuar në përgjithësi mbi ndryshimet më të fundit në aktet ligjore dhe nënligjore në lidhje me shërbimet e ndihmës personal.

Ligji për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë ndër disa ndryshime thelbësore në fushën e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, solli ndryshime të rëndësishme edhe për ndihmës personal, të cilët deri në atë kohë njiheshin me termin kujdestarë.

Sipas këtij ligji "Ndhmësi personal" është ai individ i zgjedhur dhe i udhëzuar nga një person me aftësi të kufizuara për ta ndihmuar këtë të fundit që të kapërcejë pengesat në jetën e përditshme. Në nenin 6 të ligjit detajohen shërbimet që ofrohen në kuadër të ndihmesës personale, ndër të cilat përfshihet edhe asistenca personale. Këtu përfshihen disa shërbime duhet të kenë disa karakteristika minimale, ndër të cilat gjendet edhe asistenca ose ndihmesa personale. Kështu, asistenca duhet të fokusohet në nevojat e individit dhe në zgjedhjet e tij personale, të mbulojë në mënyrë gjithëpërfshirëse të gjitha sferat e jetës, përfshirë sferën e punës, arsimit dhe aktiviteteve shoqërore, profesionale dhe të kohës së lirë, si dhe të gjitha dëmtimet e nevojat për ndihmë që rrjedhin nga dëmtimi/aftësia e kufizuar, të krijohet në formën e një shërbimi kontraktual ndërmjet individit me aftësi të kufizuara dhe ofruesit të shërbimit; të jetë nën kontrollin e personit me aftësi të kufizuara në cilësinë e konsumatorit, të kenë procedura të qarta dhe transparente ofrimi, të përfshijë të drejtën e personave me aftësi të kufizuara për të dhënë udhëzime, t'i japë mundësinë personave me aftësi të kufizuara që kërkojnë ndihmë që të mësojnë gradualisht si të japin udhëzime dhe të synojë zhvillimin e plotë të personalitetit të personave me aftësi të kufizuara në respekt të diversitetit.

Ligji ka parashikuar që rregullat, procedurat dhe kriteret e ofrimit të këtyre shërbimeve do të përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Ky vendim është miratuar në vitin 2019:

Vendimi Nr. 874, datë 24.12.2019 "Për mënyrën e ofrimit të ndihmesës personale dhe kriteret e përzgjedhjes së ndihmës personal".

Ky vendim përbën vendimin bazë për mënyrën e ofrimit dhe kriteret e përzgjedhjes së ndihmës personal dhe kjo guide është përqëndruar kryesisht në këtë vendim.

Njëkohësisht, për shkak të reformës në vlerësimin e aftësive të kufizuara, por edhe copëzimit të skemave ekzistuese të përfitimeve për shkak të aftësisë së kufizuar, është e rëndësishme të theksohet që ndihmës personal të personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë të cilët nuk janë ekonomikisht aktivë dhe nuk përfitojnë të ardhura nga skema e sigurimit të detyrueshëm shoqëror, iu vlerësohet periudhë sigurimi, për efekt përfitimi pensioni, barrë lindjeje, aksidenti në punë, sëmundjeje profesionale dhe sigurimi shëndetësor shërbimi si të tillë. Kontributet paguhen në bazë të pagës minimale, për efekt të llogaritjes së kontributit të sigurimit të detyrueshëm shoqëror, dhe përballohen nga buxheti i shtetit.¹

Pjesa tjetër e ndihmësve personal nuk kanë këtë përfitim. Ndërsa nga ana tjetër, në rrethet ku po zbatohet reforma e vlerësimit, personat me aftësi të kufizuara me kufizime të rënda dhe të thella gëzojnë të drejtën e përfitimit të ndihmës personal, kur kjo përcaktohet nga komisioni shumëdisiplinor i vlerësimit të aftësisë së kufizuar. Shkalla e nevojës për shërbimet e ndihmës personal përcaktohet në bazë të vlerësimit biopsikosocial të kryer nga komisioni shumëdisiplinor.²

¹ Vendim nr. 182, datë 26.2.2020 Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave e dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e pagesës për personat me aftësi të kufizuara, si dhe të ndihmës personal

² Vendim Nr. 722, datë 11.11.2019 "Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e aftësisë së kufizuar e të ndihmës personal, dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre"

SI PËRFITOHET NDIHMËSI PERSONAL NGA PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA?

Ndihmësi personal zgjidhet nga vetë përfituesi dhe/ose nëpërmjet mbështetjes me ndihmë në vendimmarrje, ose nga kujdestari ligjor, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

Ndihmësit personal përfitohet vetëm nëse komisionet përkatëse si më poshtë kanë përcaktuar nevojën e personit me aftësi të kufizuara për të:

- a) komisionet mjekësore për caktimin e aftësisë për punë;
- b) Komisioni Mjekësori i Përcaktimit të Verbërisë;
- c) komisionet shumëdisiplinore të vlerësimit biopsikosocial të aftësisë së kufizuar.

KUSH KONSIDEROHET NDIHMËS PERSONAL?

Ndihmësi personal ofron ndihmesën/asistencën personale në cilësinë e ndihmësit, për:

- a) kujdesin personal për personat me aftësi të kufizuara;
- b) shoqëruesit për personat e verbër;
- c) interpretuesit e gjuhës së shenjave; dhe
- ç) lehtësuesit në komunikim për personat me aftësi të kufizuara, në të folur dhe në të dëgjuar.

KUSH MUND TË JETË NDIHMËS PERSONAL?

Ndihmës personal mund të jenë:

Anëtarë të familjes;

Kujdestarë ligjorë;

Të afërm ose miq;

Punonjës të fushës sociale apo çdo person tjetër që ka marrë kualifikimet e kërkuara për ofrimin e këtij shërbimi;

Subjektet publike/jopublike që ofrojnë shërbime të ndihmësit personal, për ofrimin e këtij shërbimi, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

Organizata shërbimesh, të ngritura nga persona me aftësi të kufizuara.

CILAT JANË KRITERET QË DUHET TË PLOTËSOJË NDIHMËSI PERSONAL?

Kriteret që duhet të plotësojnë ndihmësit personal janë:

- a) të jetë në moshë madhore, mbi 18 vjeç;
- b) të mos jetë i dënuar me vendim gjykatë, të formës së prerë, për kryerjen e një vepre penale, kundërvajtjeje penale me dashje apo me vendim gjykatë për dhunë në marrëdhëniet familjare;
- c) të jetë i aftë për t'i shërbyer personit me aftësi të kufizuara;
- ç) të ketë njohuritë bazë mbi aftësinë e kufizuar, të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, si edhe mbi etikën në ofrimin e ndihmës/asistencës shtëpiake, sjellje e komunikim ose të jetë i gatshëm t'i përfitojë këto njohuri në një kohë sa më të shpejtë, me qëllim që të garantojë cilësinë e shërbimit të ofruar;
- d) të ketë marrë udhëzime përgatitore nga përfituesi për të ofruar shërbimet e ndihmësit personal;
- dh) të shprehë gatishmëri për të marrë trajnime të tjera, sipas nevojës.

CILI ËSHTË DOKUMENTACIONI QË DUHET TË DORËZOHË NDIHMËSI PERSONAL DHE KU?

Ndihmësi personal paraqet pranë administratorit shoqëror të njësise administrative kopjen e kartës së identitetit.

Për personat me aftësi të kufizuara, të cilëve me vendim gjykatë i është caktuar kujdestar ligjor, administratori shoqëror siguron kopje të vendimit të gjykatës, të cilën e bën pjesë të dosjes.

ÇFARË BËN NDIHMËSI PERSONAL?

Ndihmësi personal ndihmon personin me aftësi të kufizuara në:

- a) realizimin e veprimtarive për përmbushjen e nevojave themelore për t'u mundësuar atyre të jetojnë me dinjitet;
- b) shoqërimin jashtë shtëpisë për të siguruar pjesëmarrjen dhe përfshirjen e plotë në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe fetare;
- c) shoqërimin për marrjen e shërbimeve sociale, shëndetësore, rehabilituese e integruese dhe shoqërimi për në shkollë për fëmijët e moshës shkollore;
- ç) marrjen në kohë të mjekimeve, sipas rekomandimit të mjekut; dhe
- d) mbajtjen e higjienës personale.

Mbështetja në komunikim përfshin, por nuk kufizohen te:

- a) shërbimet e përkthyesit të gjuhës së shenjave;
- b) ndihma për të komunikuar nëpërmjet ligjërimit dhe/apo shenjave të veçanta;
- c) ndihma në përdorimin e programeve që ndihmojnë komunikimin përmes figurave;
- ç) përshtatja e informacionit të shkruar, sipas nevojave.

SA ËSHTË PAGESA E NDIHMËSIT PERSONAL?

Ndihmësit personal (me përjashtim të ndihmësve personal të personave para dhe tetraplegjikë , në zonat ku zbatohet reforma e vlerësimit, që paguhen në masën 10, 845 dhjetë mijë e tetëqind e dyzet e pesë)³, të personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë është në masën 11 190 (njëmbëdhjetë mijë e njëqind e nëntëdhjetë) lekë.

Për ndihmësit personal të personave me aftësi të kufizuara, të vlerësuar në zonat pilot, ku realizohet reforma e vlerësimit, shuma e pagesës për shërbime gjithëpërfshirëse është 120% (për personat me aftësi të kufizuara të rënda) e pagesës bazë të aftësisë së kufizuar, ndërsa shuma e pagesës për shërbime të herëpashershme është 80% (për personat me aftësi të kufizuara të thella) e pagesës bazë të aftësisë së kufizuar. Pagesa bazë për shkak të aftësisë së kufizuar është 150% e shumës së pensionit social, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”.

KUSH I MONITORON SHËRBIMET E NDIHMËSIT PERSONAL?

Monitorimi i shërbimeve të ndihmësit personal bëhet nga personi me aftësi të kufizuara ose përfaqësuesi i tij.

Megjithatë administratori shoqëror bën monitorimin dhe mbështetjen e shërbimit të asistencës personale dhe evidenton, raporton dhe referon rastet e abuzimit dhe të neglizhencës.

³ Shumat ndryshojnë vit pas viti si pasojë e indeksimit.